

KËRKESË
Nr.1590, datë 24.5.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT
“GËZIM JONUZI”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të Komisionit të Ankimit ISHMPUT, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- “GËZIM JONUZI”

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku

VENDIM
Nr. 4822, datë 13.9.2018

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 4.2.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar me vendimin nr. 694, datë 10.11.2017 të Këshillit të Ministrave dhe Ankimit për vendimin përfundimtar me Nr. 2, datë 21.7.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, ndaj subjektit Gëzim Jonuzi, protokolluar me nr. 4128 prot., datë 8.8.2018

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me gërmën “q”, të nenit 38, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative të marrë në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 2, datë 21.7.2018, në vlerën 100 000 lekë, dhe rrëzimin e ankimit të subjektit ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTOR
i komanduar në detyrë
Armando LAMAJ

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.